



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:194709  
Datë: 20.05.2024  
Numri i dokumentit: 05706746

AA.nr.438/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për çështje administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, R.S nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e avokatëve “PRO JURIS Low Firm” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës, Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, përkitazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2017/2023, të datës;02.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.05.2024, merr këtë,

**A K T V E N D I M**

Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës, Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, prishet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2017/2023, i datës;02.04.2024, dhe çështja gjykohet si në vijim; Refuzohet propozimi i paditësit, R.S nga Prishtina, me të cilin ka kërkuar nga Gjykata që të shtyhet ekzekutimi i vendimit i të paditurës, Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr.319/2023, i datës;05.09.2023, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2017/2023, të datës;02.04.2024, është vendosur “*I. APROVOHET si i bazuar propozimi i paditësit-propozuesit R.S nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson shoqëria e avokatëve Pro Juris Prishtinë. II. SHTYHET ekzekutimi i vendimit Nr.319/2023 të datës 05.09.2023 i të paditurës/kundërpropozueses Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, derisa Gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditëses.*”

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative,

konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2017/2023, të datës;02.04.2024, dhe të refuzohet propozimi i paditësit si i pa bazuar.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar pala paditëse përmes të autorizuarve të tij, me të cilën i ka propozuar Gjykatës që ankesën e të paditurës ta refuzon në tërësi si të pa bazuar dhe ta vërteton vendimin e Gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenit 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura, Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me vendimin nr.319/23 të datës;05.09.2023, ka refuzuar ankesën e me numër 319/23 dt.07.08.2023 tatimpaguesit Rexhep Spahiu.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë;01.12.2023, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet, me kërkesë për shtyerjen e ekzekutimit të tij.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, pasi ka vlerësuar propozimin e paditësit, jashtë seance, bie aktvendimin e ankimuar, me të cilin ka aprovuar si të bazuar propozimin e paditësit, me arsyetim se *“Duke zbatuar me përpikëri udhëzimet e Gjykatës Supreme, e me qëllim të vlerësimit të këtij propozimi, gjykata fillimisht ju referua nenit 22, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se: “Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t’i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t’i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”.* Gjykata poashtu ju referua edhe paragrafit 6 të nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton si në vijim: *“Paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyerjen e ekzekutimit të aktit administrativ, deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”.* Bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, gjykata pasi shqyrtoi dhe vlerësoi propozimin e paditësit/propozuesit për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit me numër 319/2023 të datës 05.09.2023 si dhe përgjigjen e të paditurës me parashtrësën e datës 01.12.2023, gjeti se propozimi për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, është i bazuar. Gjykata gjeti se me propozimin për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit, paditësi/propozuesi ka ofruar argumente të besueshme dhe se në rastin konkret janë përmbushur në tërësi dhe në mënyrë kumulative të gjitha kushtet nga neni 22 i Ligjit për Konfliktet Administrative për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar. Gjykata konstatoi se ekzekutimi i këtij vendimi do të shkaktoj dëm të riparueshëm për paditësin për faktin që i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes. Dëmi vështirë i riparueshëm po ashtu do të manifestohet me bllokimin e xhirollogarive bankare të paditësit duke i pamundësuar edhe të drejtën elementare për jetën, sepse bllokimi i tyre do t’ia pamundësonin paditësit realizimin e të drejtave subjektive. Për më tepër, dëmi i riparueshëm do të shkaktohej po ashtu për faktin se me marrjen e masave për mbledhjen e detyrueshme të borxhit tatimor ku

*do të përfshihen masat e parapara me nenin 33 deri 41 të Ligjit Nr.03.L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, sikurse që janë bllokimi i llogarive bankare, konfiskimi i pasurisë së biznesit, shitja me ankand publik e pasurisë së konfiskuar, ndalesa për largimin e pronarit dhe personave përgjegjës dhe dëme të tjera përcjellëse për paditësin. Gjykata poashtu gjeti se shtyerja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar me këtë padi, nuk është në kundërshtim me interesin publik. Përkundrazi, shtyerja e ekzekutimit të këtij vendimi, më së shumti i shërben ruajtjes së interesit publik, meqenëse kemi të bëjmë me një situatë juridike ku pretendohet mungesa e aktit nënligjor që do të duhej të nxirrej nga Ministri dhe me të cilin do të përmbusheshin obligimet ligjore nga neni 31, paragrafi 12 i Ligjit Nr.05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale dhe në të cilat do të trajtohej mënyra e trajtimit të fitimeve/humbjeve kapitale për individët, pra personat fizik si në rastin konkret, të paditësit. Mbi bazë të këtyre gjetjeve, gjykata erdhi në përfundim të qartë dhe të pakontestueshëm se shtyerja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk do t'i sillte asnjë dëm palës kundërshtare dhe as personave të interesuar dhe kjo për faktin që pas shqyrtimit dhe vendosjes sipas padisë, në rast se akti administrativ do të rezultonte të ishte në përputhje me ligjin, e njëjta do të kishte të gjitha autorizimet dhe mekanizmat ligjorë për të inkuar çfarëdo detyrimi kundrejt paditësit.”*

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, bazuar në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të aktvendimit, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktvendimi i kontestuar është i përfshirë me shkëlqje esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 nën paragrafi n), dhe nga neni 183 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili përcakton se: *”182.2, paragrafi n) Në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye, apo në te nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta ose kontradiktore, ose për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjeje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*. *“183.1 Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.”* Pra, kolegji i apelit vlerëson se nuk mund të aprovohet si i drejtë dhe ligjor qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë si në aktvendimin e saj, ngase sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, e rrjedhimisht si pasojë e vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, ka rezultuar edhe aplikimi i gabuar i të drejtës materiale, përkatësisht dispozitën e nenit 22 par.2 të LKA-së. Sepse në rastin konkret paditësi-propozuesi me kërkesë ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të derisa Gjykata të vendos në mënyrë meritorie çështjen, mirëpo, aktvendimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë për shkak të parregullsive që ka nuk mund të ekzaminohet, kjo për faktin se dispozitivi i aktvendimit është kontradiktor me arsyetimin e tij, ngase faktet vendimtare lidhur me përmbushjen e kushteve ligjore në mënyrë kumulative sipas nenit 22 paragrafi 2 të LKA-së, që të aprovohet propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk janë arsyetuar fare në raport me dispozitën ligjore nga neni 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative, veçanërisht në drejtim të plotësimit të kushteve ligjore me prova të besueshme për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nga neni 22 i LKA-së, për çka në mënyrë të bazuar theksohet në ankesë nga pala e paditur.

Prandaj, meqenëse aktvendimi ankimor është i përfshirë me të meta të tilla thelbësore për shkak të cilave i njëjti nuk mund të ekzaminohet, e rrjedhimisht i njëjti është edhe i pa qëndrueshëm. Sepse në rastin kur Gjykata aprovon kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, ajo është e detyruar që përtej përshkrimit të dispozitave relevante ligjore të përcaktuara nga neni 22 i LKA-së, ajo duhet të vlerësoj me prova konkrete argumentet në mbështetje të plotësimit të kriterëve

ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, përkatësisht të vërtetonte se cili është ai dëm që i shkaktohet paditësit nga ekzekutimi i vendimit, dhe pse ai dëm është i pa riparueshëm, po ashtu cilat prova janë vlerësuar për të vërtetuar faktin se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Me nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative është përcaktuar se shtyrja e ekzekutimit të vendimit mund të bëhet, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret paditësi-propozuesi me propozimin e ushtruar kërkon shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, mirëpo nuk e ka provuar me asnjë prove të vetme se i plotëson tre kërkesat e përcaktuara nga neni 22.2 të LKA-së.”

Mbi këto arsye, kolegji i apelit vlerëson se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara me prova konkrete për tu aprovuar propozimi dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase vlerësimi i kolegjit të apelit është se paditësi-propozuesi nuk ka ofruar prova për të vërtetuar plotësimin e tre kushteve të parapara në mënyrë komulative për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, siç përcaktohet me nenin 22 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Kjo për faktin se kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kryesisht është e mbështetur në fakte dhe prova që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, përkatësisht objektin e kërkesëpadisë së paditësit, për të cilat Gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të padisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit. Prandaj, nëse Gjykata në rastin e vendosjes sipas padisë së paditësit, gjen se vendimi i të paditurës është i paligjshëm, atëherë çfarëdo dëmi eventual i shkaktuar ndaj paditësit mund të llogaritet dhe mund të kompensohet.

Prandaj, kolegji i apelit në këtë rast, nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktvendimin e ankimuar, sepse ka të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dhe se i njëjti është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten edhe arsyetimin e tij, përkatësisht duke mos dhënë asnjë arsye mbi faktet vendimtare.

Në këtë kuptim, kolegji i apelit vlerëson se për shkak të qëndrimit të gabuar juridik dhe mos arsyetimit të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka lëshuar të vërtetojë faktet qenësore për zbatimin e dispozitave ligjore të lartcekura, për çka ankesa e palës së paditur është dashur që të aprovohet, ndërsa aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet duke e refuzuar si të pa bazuar propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Nga arsyet e dhëna me lart, e në pajtim me nenin 49 të LKA-së, lidhur me nenin 209 paragrafi 1 nën paragrafi c) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË  
AA.nr.438/2024, datë;13.05.2024

Kryetari i kolegjit,  
Hajriz Hoti